

BREAKING NEWS

x

MINISTRIA PUBLIKON BILANCIN, JA SA RASTE TE REJA JANE SHENUAR 24 ORET E FU...

AKTUALITET

Kush është Jurgen Kurti? Menaxheri i VIP-ave që u ekzekutua sonte, i përfshirë në vrasjen e babait të tij

SHKRUAR NGA SOT.COM.AL
18 MARS 2019

Facebook

WhatsApp

Twitter

Email



Një 26-vjeçar ka mbetur i vrarë mbrëmjen e kësaj të hëne në kryeqytet. Ngjarja ndodhi në zonën e Tiranës së Re, në rrethana ende të paqarta. Burime bëjnë të ditur se viktimi është Jurgen Kurti.


“Rreth orës 22:20, në rrugën “Zef Jubani”, në rrethana ende të paqarta është vrarë me armë zjarri shtetasi J. K., rreth 26 vjeç. Grupi hetimor po punon për zbardhjen e rrethanave të ngjarjes, identifikimin dhe kapjen e autorit/ve. Sherbimet e Policisë po krehin zonën si dhe janë ngritur pika kontrolli për kapjen e autorit/eve”, thotë policia në një njoftim paraprak për mediat.

Jurgen Kurti nuk është një emër i njohur për drejtësinë, por edhe për opinionin publik. 26-vjeçari ka qenë protagonist në dy vrasje. Në 2016-n, ai u arrestua sëbashku me dajën e tij për vrasjen e të atit, por u la i lirë pasi ky i fundit pranoi krimin. Ndërsa një vit më vonë, në 2017-n, ai ishte pjesë e një sherri ku i vrarë mbeti pronari i një marketi në qytetin e Durrësit.

Kjo është vrasja e dytë që ndodh në Tiranë në harkun kohor prej 2 ditësh. Pasditen e së shtunën, një 62-vjeçar u vra në kodrat e liqenit artificial, ndërkohë që kishte dalë për vrap.

YOU MAY LIKE

by **mgid**



Već za 5 dana krvni sudovi će ponovo biti kao sa 25 godina!

HYPERTEA